



Tiranë, 25 korrik 2025

Letër e hapur drejtuar

Kryeministrat e Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama

Presidentit e Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj

Të nderuar z. Kryeministër dhe z. President,

Në emër të Asociacionit të Gazetarëve të Shqipërisë, po ju drejtohemë në një nga momentet më të errëta të ndërgjegjes njerëzore dhe të rendit ndërkombëtar dekadat e fundit. Gaza po shkatërrohet. Fëmijët po vdesin të uritur. Spitalet janë kthyer në varreza heshtjeje. Gazetarët, të vetmit zë i mbetur i së vërtetës, po vriten.

Ju shkruajmë për të kërkuar jo vetëm një qëndrim politik, por një reagim njerëzor. Ky nuk është një apel diplomatik; është një thirrje nga ndërgjegjja jonë si gazetarë, si qytetarë, si njerëz.

Ajo që po ndodh në Gaza nuk është një luftë. Është një gjenocid. Një popull i tërë po dëbohet, shfaroset, zhduket, ndërsa qeveria e Izraelit përdor urinë si armë, bllokon ndihmat humanitare, ndalon ujin, barnat, karburantin dhe i ndalon gazetarët ndërkombëtarë të hyjnë për të dëshmuar. Është një akt i strukturuar i shfarosjes së një popullsie civile.

Fëmijët po vdesin në krahët e prindërve të tyre. Bebeve në inkubatorë po u shuhet jeta nga mungesa e oksigjenit. Njerëzit po vdesin nga uria në heshtje, ndërkohë Shqipëria nuk guxon të shqiptojë fjalën që duhet: **GJENOCID**.

Sipas Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (IFJ), që nga fillimi i luftës janë vrarë të paktën **187 gazetarë dhe punonjës të medias**. Të vetmit zëra që guxojnë të dëshmojnë krimet po heshten me qëllim. Heshtja e tyre është e planifikuar ose përmes vrasjes direkte, ose përmes urisë, ose përmes izolimit.



**Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë
Association of Journalist of Albania**

Të gjithë gazetarët ndërkontëtarë janë ndaluar të hyjnë në Gaza. Gazetarët lokalë po mbajnë gjallë fijen e vetme të informacionit dhe të së vërtetës që ende mund të shpërndahet në botë. Edhe kjo fije po këputet.

Shqipëria nuk është vend i madh, por ka një zë që mund të dëgjohet kur guxon të flasë. Ka një histori të dhimbshme që i njeh krimet e heshtura. Ka një shoqëri që e njeh vuajtjen dhe pasojat e persekutimit.

Ne kërkojmë nga ju Zoti.Kryeministër dhe Zoti.President, që me përgjegjësi dhe ndershmëri të mbani një qëndrim publik dhe të qartë për këtë tragjedi:

- Të dënoni publikisht gjenocidin që po ndodh në Gaza.
- Të bëjnë thirrje për ndalimin e vrasjeve të civilëve dhe mbrojtjen e gazetarëve.
- Të kërkojnë lejimin e hyrjes së ndihmave humanitare dhe aksesin e gazetarëve ndërkontëtarë në Gaza.
- Të mbështesin një hetim ndërkontëtar për përdorimin e urisë si armë lufte dhe për shkeljet sistematike të së drejtës ndërkontëtarë.
- Të mos fshihen pas deklaratave të kujdeshme diplomatike, por të shprehen me guxim moral dhe politik.

Të qëndrosh neutral përballë gjenocidit nuk është diplomaci. Është bashkëfajësi. Është nënshtrim para krimit. Dhe është turp që historia nuk e fal.

Nëse nuk e dënojmë sot këtë krim, nesër nuk do të kemi më të drejtë të flasim për padrejtësi.

Me respekt dhe me përgjegjësi profesionale,

Isa Myzyraj

Kryetar

Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë



Gre



Asociacioni I Gazetarëve të Shqipërisë
Association of Journalist of Albania

Tirana, 25 July 2025

Open Letter to:

**Prime Minister of the Republic of Albania, Mr. Edi Rama
President of the Republic of Albania, Mr. Bajram Begaj**

Dear Mr. Prime Minister and Mr. President,

On behalf of the Association of Journalists of Albania, we write to you during one of the darkest moments in recent human history and in the moral order of the international community. Gaza is being destroyed. Children are dying of hunger. Hospitals have become silent cemeteries. Journalists—the last remaining voices of truth—are being killed.

We write not only to request a political position but to call for a human response. This is not a diplomatic appeal; it is a call from our conscience—as journalists, as citizens, and as human beings.

What is happening in Gaza is not a war. It is a genocide. An entire people is being displaced, exterminated, and erased, while the Israeli government uses starvation as a weapon, blocks humanitarian aid, cuts off access to water, medicine, and fuel, and prohibits international journalists from entering to bear witness. This is a systematic act of annihilation against a civilian population.

Children are dying in the arms of their parents. Babies in incubators are losing their lives due to a lack of oxygen. People are dying silently of hunger—while Albania dares not utter the one word it must: **GENOCIDE**.

According to the International Federation of Journalists (IFJ), at least **187 journalists and media workers** have been killed since the start of the war. The only voices daring to report on these crimes are being deliberately silenced—either through direct killing, starvation, or isolation.

All international journalists are banned from entering Gaza. Local journalists are keeping alive the last thread of information and truth that can still be shared with the world. Even that thread is being cut.



**Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë
Association of Journalist of Albania**

Albania is not a large country, but it has a voice that can be heard—when it dares to speak. It has a painful history that knows the scars of silenced crimes. It has a society that understands suffering and the consequences of persecution.

We therefore call upon you, Mr. Prime Minister and Mr. President, with responsibility and integrity, to take a clear and public stand on this tragedy:

- To publicly condemn the genocide unfolding in Gaza.
- To call for an immediate end to the killing of civilians and for the protection of journalists.
- To demand the unimpeded entry of humanitarian aid and international media access into Gaza.
- To support an international investigation into the use of starvation as a weapon of war and other systematic violations of international law.
- To not hide behind cautious diplomatic language, but to speak out with moral and political courage.

Remaining neutral in the face of genocide is not diplomacy. It is complicity. It is surrender in the face of crime. And it is a stain that history does not forgive.

If we do not condemn this crime today, we will have no right to speak of injustice tomorrow.

With respect and professional responsibility,

Isa Myzyraj
Chairman
Association of Journalists of Albania

